



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVO-GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEKNOLOGIJE

SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARCHIVE-ARCHIVE SECTOR

Njësia Org.
Org. Jedinica
Org. Unit
Nr. i faqeve
Br. strana
No. pages

Nr. Prot.:
Broj Prot.:
Prot. No.:
Data:
Datum:
Dato:

Prishtinë, / g



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Nr. 2600 prot
dt. 20.4.2023



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë
dhe Inovacionit/Ministarstvo Obrazovanja i
Nauke, Tehnologije i Inovacija
Ministry of Education, Science, Technology
and Innovation

PROGRAM
për zbatimin e Marrëveshjes
ndërmjet

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë
dhe

Qeverisë së Republikës së Kosovës
për bashkëpunimin në fushën e arsimit dhe shkencës

Në zbatim të “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunimin në fushën e arsimit dhe shkencës”, nënshkruar në Tiranë, më 08.03.2010, miratuar me Vendimin nr. 265 datë 21.04.2010 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunimin në fushat e arsimit dhe të shkencës”, hyrë në fuqi më datë 01.12.2011, hartohet Programi ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) të Republikës së Kosovës.

Programi promovon bashkëpunimin dypalësh dhe atë rajonal, në fushën e arsimit dhe shkencës.

Ministria e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Republikës së Kosovës, janë angazhuar të ndërtojnë ura komunikimi mes komuniteteve kërkimore shkencore të të dy vendeve, me qëllim promovimin e bashkëpunimit në fushat e arsimit dhe shkencës.

Neni 1

Qëllimi i Programit

Qëllimi i Programit është financimi i projekteve të përbashkëta kërkimore për të nxitur bashkëpunimin në aktivitete të kërkimit shkencor mes institucioneve kërkimore-shkencore dhe komuniteteve shkencore të të dyja vendeve.

Programi synon gjithashtu sigurimin e një mundësie për hulumtuesit/punonjësit shkencorë për të bashkëpunuar në një mjedis ndërkombëtar dhe për të zhvilluar karrierën e tyre shkencore, duke siguruar pjesëmarrjen e kërkuesve të rinj dhe barazinë gjinore në kërkim shkencor.

Neni 2

Fushat e bashkëpunimit dhe disiplinat shkencore

Programi është i hapur për fushat e kërkimit shkencor në të dy vendet si: shëndeti, shoqëria, arsimi, kultura, ekonomia dhe shkencat humane e sociale, shkencat albanologjike, burimet natyrore, energjia, mjedisi dhe ndryshimet klimatike, bujqësia, ushqimi dhe bioekonomia.

Neni 3

Kohëzgjatja e projekteve

Kohëzgjatja e secilit projekt të financuara në kuadër të këtij Programi, do të zgjasë për një periudhë maksimumi 2 (dy) vjeçare, nga momenti i nënshkrimit të kontratave për financimin e secilit projekt.

Neni 4

Kriteret e Aplikimit

Për Republikën e Shqipërisë: Të drejtën për të aplikuar në këtë Program e kanë Institucionet e Arsimit të Lartë, të përcaktuara si të tilla në Ligjin Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" të cilat, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, zhvillojnë kërkim shkencor.

Për Republikën e Kosovës: Të drejtën për të aplikuar në këtë Program e kanë të gjitha institucionet kërkimore-shkencore që i plotësojnë kushtet në bazë të Ligjit nr. 04/1.-135 për veprimtari kërkimore shkencore dt. 28 mars 2013 (gazeta zyrtare nr. 11/02 maj 2013), Programit Kombëtar për Shkencë si dhe legjislacionit në fuqi që rregullon fushën e arsimit të lartë dhe shkencës në Republikën e Kosovës.

Neni 5

Vlerësimi i aplikimeve

Projekt propozimet e aplikuara në kuadrin e këtij Programi do të vlerësohen nga ekspertët e fushave shkencore përkatëse të secilit vend, në mënyrë të pavarur, si edhe nga Komisioni i Përbashkët Shqipëri-Kosovë për Bashkëpunimin Shkencor dhe Teknologjik (në vijim “Komisioni”) i formuar nga të dyja vendet.

Vlerësimet teknike të projekteve të propozuara do të bëhen sipas kritereve të vendosura nga secili vend në mënyrë të pavarur.

Në përfundim të vlerësimit teknik nga ekspertët, më pas Komisioni i Përbashkët Shqipëri-Kosovë do të arrijë konsensus për përzgjedhjen e projekteve fituese. Rezultatet e përzgjedhjes së projekteve do të shpallen pas mbledhjes së Komisionit të Përbashkët dhe financimi i tyre do të kryhet pas nënshkrimit të kontratave përkatëse nga secili vend, konkretisht për Republikën e Shqipërisë nga AKKSHI dhe për Republikën e Kosovës nga MASHTI.

Neni 6

Përbërja e komisionit të përbashkët të vlerësimit

Komisioni i përbashkët i vlerësimit përbëhet nga:

Pala shqiptare:

1. Drejtori i Përgjithshëm i AKKSHI-së
2. Drejtori i Drejtorisë së Politikave të Arsimit të Lartë, MAS
3. Përgjegjësi i Sektorit të Zhvillimit të Kërkimit Shkencor, MAS

Pala e Kosovës:

1. Drejtori i Departamentit të Arsimit të Lartë, MASHTI
2. Udhëheqësi i Divizionit për Inovacion Shkencor dhe Transfer të Dijes, MASHTI
3. Përfaqësues nga Këshilli Shkencor, MASHTI

Neni 7

Financimi i Projekteve

Në total Komisioni do të përzgjedhë dhe financoje deri në 16 projekte fituese. Shuma maksimale e një projekti, do të jetë deri në 20,000 Euro për dy vite (24 muaj) dhe do të bashkëfinancohet në mënyrë të barabartë nga të dyja vendet.

Për palën shqiptare institucioni financues është AKKSHI, ndërsa për palën kosovare është MASHTI.

Mbështetja financiare e dhënë nga palët për grupet e kërkimit duhet të plotësojë nevojat financiare për realizimin e projektit, dhe ka për qëllim të financojë kostot që lidhen me natyrën ndërkombëtare të projekteve, shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit (kryesisht transportin dhe shpenzimet për dietat ditore sipas legjislacionit në fuqi të vendeve). Çdo grup kërkimor mund të aplikojë për mbështetje financiare nga institucione të tjera për të njëjtin projekt kërkimi duke evituar mbivendosjen e financimeve. Financuesit ruajnë të drejtën e vendosjes së kushteve specifike të financimit si dhe ato të monitorimit dhe kontrollit financiar bazuar në kuadrin ligjor të secilit vend.

Neni 8

Pronësia intelektuale

Kërkuesit duhet të ndërmarrin hapat e duhur për të siguruar mbrojtjen e pronësisë intelektuale që do të mund të rezultojë nga projektet e përbashkëta të kërkimit.

Neni 9

Etika dhe Integriteti i Kërkimit

Aplikantët duhet të respektojnë parimet kryesore të etikës shkencore dhe asaj profesionale. Procesi i kërkimit, si dhe studimi shkencor, artikujt shkencore, botimet shkencore, instrumentet e dokumentete e kërkimit etj. që do të prodhohen në kuadër të këtij projekti, do të jenë në përputhje me parimet e kodit të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor, në përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor kombëtar dhe evropian lidhur me etikën në kërkimin shkencor, si më poshtë vijon:

- Respektimi i dinjitetit dhe integritetit njerëzor;
- Sigurimi i ndershmërisë dhe transparencës ndaj subjekteve kërkimore dhe veçanërisht marrja e pëlqimit dhe informimit;
- Sigurimi i privatësisë dhe konfidencialitetit;
- Promovimi i drejtësisë dhe i gjithëpërfshirjes;
- Minimizimi i dëmit dhe përfitimi maksimal;
- Respektimin dhe mbrojtjen e mjedisit dhe gjeneratave të ardhshme, etj.

Neni 10
Dispozita përfundimtare

Ky Program hyn në fuqi me nënshkrimin e tij, më 14 prill 2023.


Ndryshimet në këtë Program mund të propozohen nga palët. Ndryshimet e propozuara do të marrin formë të prerë pasi palët të bien dakord reciprokisht në formë të shkruar. Ky Program do të jetë në fuqi për një afat të pacaktuar, nëse njëra prej palëve nuk e njofton palën tjetër, me shkrim, për ndërprerjen e saj.

Nënshkruar në 4 (katër) kopje origjinale të barasvlershme në gjuhën shqipe.

Për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit
të Republikës së Shqipërisë

EVIS KUSHI

MINISTËR



Për Ministrinë e Arsimit, Shkencës,
Teknologjisë dhe Inovacionit
të Republikës së Kosovës

ARBËRIE NAGAVCI

MINISTËR

